REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**
**DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËEBIMEVE MBËSHTETËSE**
**SEKTORI JURIDIK DHE I MARRËDHËNIEVE LIGJORE**

Tiranë më 25.11.2021

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

## 25 GUSHT – 25 Nëntor 2021

| Nr | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfudnimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 23.08.2021 | 1.A ka marrë Ministria e Mjedisit një kërkesë nga kompania "Sh***" për të dhënë lejën mjedisore për hapjen e pusit vlerësues?<br>2. A ka Ministria e Mjedisit mekanizma dhe mjete për ta vleresuar impaktin e një | 24.08.2021 | 1. Ministria ka marre nje aplikim me AN3*******, nga “Sh***’’ për projektin "Ndryshimet në Projektin Sh**** (Vendet Alternative C dhe D të Pusit të Vlerësimit". Bashkangjitur gjeni Vendimin për VNM Paraprake për këtë projekt.<br><br>Sjellim në vëmendje se aplikimi për procedurat e VNM-së bëhen nëpërmjet sistemit e-albania dhe aplikimi shkon direkt në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit e më pas dërgohet në AKM, në bazë të VKM-së Nr.714, datë: 06.11.2019. Pra për çdo detaj të projektit, mund të drejtoheni pranë Sektorit të VNM-së në MTM.<br><br>2/3.Kjo është një përgjigje që i takon MTM<br>4. Procedura e Vleresimit të Ndikimit në Mjedis është kryer | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | procesi të tillë në mjedis?<br>3. Cilat organizma e kontrollojnë ndikimin negativ të hapjes së një pusi të tillë në mjedis?<br>4. Mbi cilat baza jepet leja mjedisore për hapjen e një pusi vlerësues? | | në mbështetje të:<br>• Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis",<br>• VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore:<br><br>si dhe të gjitha institucioneve të përfshira në vendimarrje, sipas bazës ligjore të sipërcituar.<br><br>Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve të lëshuara nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se subjekti "Sh***" është i pajisur me Leje Mjedisi me PN****, PN****, PN-****.<br>Në sistemin e aplikimit ëëë.int.qkl.gov.al nuk ka kërkesa për Leje Mjedisore nga subjekti "Sh****" | | |
| | *********<br><br>27.08.2021 | ***************<br>1- A janë ende të vlefshme licencat e marra nga kompania "Sh****", PN-***, PN-****, PN-****<br><br>2- Te cilës kategori janë këto leje, janë të tipiat A,B apo C ? | *********<br><br>30.08.2021 | ************************************************<br>Nga verifikimi i lejeve të kërkuara nga ana juaj mund të bëhet pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.<br><br>Verifikimi sipas kërkesës suaj mund të bëhet në websitin e mëposhtëm.<br><br>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/ | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 25.08.2021 | Lidhur me HEC-in e propozuar për ndërtim nga subjekti “P****” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Palushi”, me kapacitet prodhues deri në 2 më, në pellgun ujëmbledhës të Përroit të Bicajt, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, kërkoj informacion lidhur me: 1. Kur është paraqitur aplikimi nga subjekti “P****” sh.p.k. për miratimin e VNM? 2. A është miratuar VNM për këtë subjekt? 3. A i ka realizuar ky subjekt dëgjesat publike për projektin në fjalë? 4. Nëse po, na i vendosni në dispozicion | 25.08.2021 | **Pika 1 dhe 2.**<br>Subjekti “P****” sh.p.k. është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, Nr. 1678Prot, , për projektin “Ndërtimi i HEC ”, me vendodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Bicajt, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës. (Bashkangjitur Vendimi i dhene nga AKM)<br>Procedura është kryer në bazë të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 3. Industria e energjisë /ë) Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike dhe VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.<br>Ky vendim mbështetet në Miratimin Paraprak nga MEI me Nr. 6748/3, datë 19.06.2018, “Për vazhdim proçedure për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë’’ për ndërtimin e Hidrocentralit “Palushi”, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Bicajt, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.<br><br>**Pika 3 dhe 4.**<br>(Bashkangjitur Formulari i dëgjesës me publikun)<br><br>**Pika 5.**<br>Në Vendimin e dërguar, në faqen 2 të tij, gjendet edhe mendimi i Agj. Kombëtare të Zonave të Mbrojtura<br><br>**Pikat 6, 7 dhe 8.**<br>Për kontratat koncensionare, lutemi drejtohuni institucionit | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dokumentet që posedoni; 5. A prek ky projekt Zonat e Mbrojtura apo zonat buferike? 6. A është miratuar leja koncensionare për këtë subjekt? 7. Nëse po, na e vendosni në dispozicion; 8. (Nëse është miratuar leja koncensionare) A ka konstatuar AKM ndonjë shkelje nga ana e subjektit? | | përgjegjës (që nuk është AKM).<br><br>Midis të tjerave Vendimi është zbardhur me kushte si:<br>-Ky vendim është i vlefshëm, nëse ndërtimi i objektit është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative).<br>-Ky vendim është i vlefshëm pasi subjekti të pajiset me leje shfrytëzimi të burimeve ujore nga KBU përkatëse.<br>**Pra procedura e VNM-së nuk është leje/licensë përfundimtare për zhvillimin e një projekti**, por është një akt që lëshohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, i cili vendos kushte në funksion të mbrojtjes së mjedisit, sipas parimeve të Ligjit Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".<br><br>( u vune ne dispozicion edhe aktet e kerkuara, 'Formulari i dëgjesës me publikun, zhvillimi i dëgjesës publike , VNM ) | | |
| 3 | 07.09.2021 | Kërkesë për projekt propozim nqs AKM është e interesuar | 07.09.2021 | Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.568 datë 17.07.2019, është institucion ekzekutiv.<br><br>Ju lutem, nëse keni projekte dhe ide, drejtohuni pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, i cili është organi kompetent që shqyrton dhe vlerëson projekt-propozimet. | Përfunduar | Nuk ka |
| 4 | 08.09.2021 | Informacion në lidhje me sistemin ligatinor Vjosë-Nartë për periudhën 01.01.2020-01.09.2021 (pika | 15.09.2021 | Në vlerësim të kërkesës së përcjellë në lidhje me sistemin ligatinor Vjosë-Nartë, brenda fushës së veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit,I'u informojmë se të gjitha subjektet tregtare që janë mbajtës të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve janë të publikuara në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve pranë Qendrës | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6,7,8 -AKM) VNM, Monitorime dhe emrat e subjekteve të miratuar për të vepruar në këtë sistem ligatinor ?<br><br>1. Kopje të korrespondencës midis Ministrisë se Mjedisit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Zhvillimit Rural për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e pikës 5/2 të VKM Nr.712/2013 , ndryshuar me VKM Nr.237 datë 17/04/2019 , ndryshuar me VKM Nr. 435, datë 11.7.2018 Nr.452/2013, për të gjitha procedurat e konkurrimit të zhvilluara në sistemin ligatinor Vjosë-Nartë për periudhën | | Kombëtare të Biznesit (QKB).<br><br>Kërkuesi mund të kontrollojë për çdo informacion, aktivitet, subjekt apo vendndodhje në linkun e mëposhtëm.<br><br>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/<br><br>Regjistri Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, ka për qëllim të sigurojë aksesin e lirë të publikut në përputhje me ligjin. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 01.01.2020 deri më datë 01.09.2021.<br>*2*. Kopje të hartës që i bashkëlidhet VKM Nr .680, datë 22.10.2004.<br>3. Kopje të Rregullores së administrimit të peizazhit ujor/tokësor të mbrojtur të sistemit ligatinor Vjosë-Nartë .<br>4.Kopje të dokumenteve të parashikuara në nenin 15 të ligjit 8906 , Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur si dhe dokumentet e miratuara nga Ministria e Mjedisit për mbrojtjen e peizazhit ujor/tokësor të mbrojtur të sistemit ligatinor Vjosë-Nartë<br>5. Në bazë të nenit | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4/4, të ligjit 8906, të ndryshuar , duke qenë se në zonën ligatinore të Kallëngës është hapur një kanal i madh që ka bashkuar ujerat e ëmbla të liqenit me ato të kripura të detit kërkoj kopje të lejeve mjedisore që janë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për këtë zonë.<br>6. Kopje të studimeve dhe raportin e plotë të vlerësimit të ndikimit në mjedis të paraqitur nga shoqëria A****** shpk., nëse një i tillë ekziston për prishjen e habitatit të Kallëngës pjesë e zonës së mbrojtur Vjosë –Nartë dhe bazën ligjore ku është mbështetur prishja e biodiversitetit të | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kësaj zone.<br>7. Kopje të dokumenteve të monitorimit të zonës së mbrojtur sistemi ligatinor Vjosë-Nartë .<br>8. Emrat e subjekteve që kanë marrë miratim të kryejnë veprimtari të lejuar në zonën e mbrojtur sistemi ligatinor Vjosë-Nartë nga data 01.01.2020 deri me datë 01.09.2021. | | | | |
| 5 | 08.09.2021 | Informacion për lejet minerare dhe shfrytezimin e gurit gëlqeror në RSH.<br>1-Sa leje minerare që kanë si objekt shfrytëzimi gur gëlqeror, gëlqeror i mermerizuar, gëlqeror pllakor, gur dekorativ, mermer janë aktive aktualisht në vendin | 15.09.2021 | Bazuar në Ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe VKM-së Nr.538 datë 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullimeve nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar, ju mund të kontrolloni për çdo informacion në linkun e mëposhtëm.<br><br>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/ | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | tonë?<br>2-Ju lutem na vini në dispozocion listën e subjekteve që aktualisht janë të pajisur me një licencë të tillë dhe zonat ku e ushtrojnë aktivitetin dhe sipërfaqen që ka në shfrytëzim.... Po ashtu, ju lutem bashkangjisni pranë cdo subjekti, kohën kur e ka marrë licencën dhe deri në cilin vit ka të drejtë ta ushtrojë këtë veprimtari?<br>3-Sa prej tyre ushtrojne aktivitetin në zona të mbrojtura?<br>4- Cilat janë kriteret për të ushtruar aktivitetin në një zonë të mbrojtur?<br>5- Gjatë kontrolleve | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të ushtruara sa është nurmi i kompanive që u është pezulluar leja dhe në cilat zona janë ato?<br>6-Nëse shkelet leja cilat janë penalitet ndaj subjektit privat dhe cili është institucioni që duhet ti monitorojë?<br>7- Cilat janë detyrimet e firmave private që lindin nga kjo leje shfrytëzimi?<br>8- Cilat janë problematikat më të shpeshta të konstatur në këtë sektor? | | | | |
| 6 | 22.09.2021 | Informacion në lidhje me ndërtimin që po bëhet ( datë 21 dhe 22 shtator 2021) brenda Parkut Kombëtar të | 30.09.2021 | Referuar kërkesës për informacion në lidhje me Parkun Kombëtar të Valbonës, konkretisht Quku i Valbonës dhe Maskollata.<br>Bazuar në NIPT-in e kompanisë "K6****",që ju na keni referuar, sipas regjistrit të Qëndrës Kombëtare të Biznesit rezulton të jetë subjekti "T*****". | Përfundaur | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Luginës së Valbonës, konkretisht në lagjen Quku i Valbonës dhe Maskollata. Dy eskavatorë, me sa duket në pronësi të B**** C****, kanë shtyrë sasi të mëdha të materialit në lumë. Nëse kjo është pjesë e punimeve të HEC-it T**** , ne kërkojmë më tej kopje të çdo leje mjedisore që i janë dhënë kësaj kompanie si dhe të gjithë informacionin që keni për kufijtë e saktë të territorit që lejohen të përdorin, pasi zona e prekur aktualisht nuk ishte përfshirë në lejën e tyre mjedisore siç e kuptojmë ne. Për më tepër çdo informacion që keni në lidhje me | | Ju bëjmë me dije se që nga viti 2014 e në vazhdim nuk ka aplikim për procedurë të VNM nga kjo shoqëri.<br>Në dijeninë tonë ky subjekt, është pajisur me Leje Mjedisi me Nr. 468 Prot / 2009 për HEC T****, periudhë kjo, kur procedura e Lejeve ndiqej nga Ministria dhe jo nëpremjet QKB-së apo AKM-së.<br>Konkretisht Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk disponon asnjë të dhënë për periudhën përpara vitit 2014.<br><br>Për sa i përket kërkesës për verifikim në terren me shkresën Nr.4465/2 prot /.2021, Agjencia Kombëtare e Mjedisit i'a ka përcjellë për verifikim Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, në zbatim të VKM-së Nr.568 / 2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit". | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | statusin aktual ligjor të projektit dhe mbajtësin e koncesionit T*** shpk. Në rast se agjencia juaj nuk ka qasje në asnjë nga informacionet e kërkuara, ne kërkojmë që ju ta përcillni kërkesën tonë tek autoriteti përkatës. Ne gjithashtu kërkojmë që të informoni inspektoriatin për këtë aktivitet dhe kërkoni që ata të hetojnë se çfarë po ndodh, dhe nëse ndërtesa ka një lejë të vlefshme leje mjedisore.<br><br>**************** | | | | |
| | *********<br>04.10.2021 | 1. Domethënë, për "Lejen Mjedisore Nr. 468 Prot/2009, Vendimi Nr. 9" - duhet të kërkoj nga Ministria e Mjedisit? Sepse në fakt i dërgova një | *********<br>16.10.2021 | Pika 1. Si edhe ju kemi bere me dije me pare, Agjencia Kombetare e Mjedisit nuk disponon te dhena per periudhen  e vitit 2009, kohe kjo kur procedura e lejeve mjedisore ndiqej nga Ministria e Mjedisit, me dosje aplikimi fizike.<br>Pika 2. Nga viti 2014 e ne vazhdim, nuk ka asnje aplikim ne Agjencine Kombetare te Mjedisit nga subjekti "TPlan" sh.p.k. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kopje të kërkesës koordinatorit brenda Ministrisë, por siç e kam parë, ai dërgoi një kërkesë në zyrën tuaj. Edhe ashtu siç e kuptoj, sipas ligjit për të drejtën e informimit, a mund të jetë përgjegjësi e AKM-së që ta përcjell kërkesën tonë në zyrën përkatëse? Çdo ndihmë me këtë do të vlerësohej shumë!<br><br>2. A mund të kërkoj më pas ndonjë informacion në lidhje me kërkesat për të punuar në Luginën e Valbonës të paraqitura nga "T*****HC" që nga viti 2014, dhe kopjet e çdo leje rezultuese të dhënë? Rreth vitit 2019, projekti zhvendosi | *********<br><br>14.10.2021 | lidhur me punime per zhvendosjen e termocentralit 500 m.<br>Pika 3. Për sa i përket kërkesës për verifikim në terren me shkresën Nr.4465/2 prot datë 29.09.2021, Agjencia Kombëtare e Mjedisit i'a ka përcjellë për verifikim Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër, Lezhë, Kukës, në zbatim të VKM-së Nr.568 / 2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit".<br><br>**************************************************<br><br>Përgjigjia e kthyer nga ARM Shkodër, Lezhë, Kukës me shkresën Nr.1096/1 prot /.2021 dhe shkresa Nr.1064/1 prot /2021 " Bazuar në nenin 27 të ligjit Nr.10433/2011 'Për inspektimin në RSH' dhe mbështetur në vendimin Nr.568 / 2019 'Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM', ligji Nr.10431 / 2011 'Për mbrojtjen e mjedisit', ligji Nr.10448 / 2011 'Për lejet e mjedisit' i ndryshuar. Me autorizimin Nr.14053 prot /.2021 u ngrit grupi i punës për kontrollin në terren. Nga verifikimi rezultoi se subjekti T'*** sh.p.k ishte në fazën përfundimtare të ndërtimit në lidhje me hapjen e trasesë, futjen e tubacioneve, përfundimin e veprës së marrjes, ndërtimin e degëzimit për kanalin e vaditjes për fermerët që marrin ujin në atë, konkretisht ky subjekt kishte përfunduar afërsisht 80% të punimeve ndërtuese. Të gjitha këto punime i ka realizuar përpara vitit 2020, kjo në dukje nga gjendja e mjedisit. Aktualisht ky subjekt është në fazën përfundimtare të ndërtimit të godinës ku do të montohen makineritë. Vlen të theksohet se HEC-i është në gjurmën e vjetër ku ka qënë HEC- i ndërtuar para viteve 1990 që ka shërbyer për furnizimin me energji elektrike për fshatin Valbonë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vendndodhjen e termocentralit të tyre 500 metra më poshtë, dhe besoj se ata nuk kërkuan asnjë leje për këtë ndryshim në plan.<br>3. Faleminderit që njoftuat inspektoratin kombëtar. Deri më sot nuk kam pasur asnjë kontakt prej tyre. A mund të më jepni ndonjë informacion kontakti që të mund t'u dërgoj atyre detaje të mëtejshme? Ankesa aktuale është se ata kanë hedhur buldozer sasi masive të materialit ndërtimor në lumë. Unë nuk mund të besoj se kjo është e lejuar asgjësimi, dhe do të doja të jepja më shumë informacion në lidhje me vendndodhjen e | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | saktë të punimeve. | | | | |
| 7 | 05.10.2021 | 1. Sa kontrata ka në rang kombëtar për pastrimin e mbetjeve spitalore?<br>2. Sa kontrata ka vetëm për qarkun e Elbasanit?<br>3. Vënien në dispozicion të kontratave nga janar 2020 deri në 15 shtator 2021.<br>4. Ku depozitohen mbetjet spitalore të spitaleve në qarkun Elbasan?<br>5. A janë identifikur raste të depozitimit në lumin Shkumbin të mbetjeve spitalore? Nëse po, nga cilat kompani, dhe të cilave spitale?<br>6. A ka patur penalitete ndaj kontratorëve që nuk kanë respektuar afatet dhe cilat janë e kompanitë që janë penalizuar? | 18.10.2021 | Në zbatim të VKM-së Nr. 568 /2019, ARM Berat,Elbasan, Korçë nuk disponon të dhëna per informacion e kërkuar. Pas krijimit të institucionit të ARM Berat, Elbasan, Korçë, si dhe për shkak të Covidit-19 dhe mungesës së logjistikës, procesi i inspektimit ka rifilluar në muajin Qershor 2021 dhe në vazhdim. Gjatë muajve Qershor – Korrik, janë kryer inspektime në subjektet P*** medical shpk dhe E*** të cilat objekt të aktivitetit të tyre kanë "incenerimin e mbetjeve të rrezikshme në një instalim". Të dyja subjektet e inspektuara janë të pajisura me Leje Mjedisore dhe me Licencen përkatëse. Deri më tani nuk ka patur ankesa për depozitimin e mbetjeve spitalore në Lumin Shkumbin.<br>Në muajt në vazhdim institucioni ynë do të kryejë inspektime ndaj gjeneruesve të mbetjeve spitalore. | Përfunduar | Nuk ka |
| 8 | 06.10.2021 | 1-Nga janari i vitit 2020 deri në korrik 2021 sa kg produkte të | 13.10.2021 | Bazuar në nenin 22, pika 1 e Kushtetutës së R.SH. si dhe në Ligjin Nr.119/2014,"Për të Drejtën e Informimit" Mbi sasitë e produkteve të skaduara/dëmtuara të asgjësuara nga operatorët E*** dhe H***, Ju bëjmë me dije se Agjencia Rajonale e | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | skaduara ka asgjësuar kompnia E**** në presencë të inspektorëve të mjedisit ?<br>2-Lutemi të na vendosni në dispozicion procesverbalet e asgjësimit për periudhën Janar 2020 –Korrik 2021.<br>3-Sa kg produkte të skaduara ka asgjësuar Shoqëria H*** nga muaji Mars 2020 deri në Korrik 2021 ?<br>4-Vënia në dispozicion e procesverbaleve te asgjesimit per kete periudhe kohore. | | Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër bazuar në VKM-në Nr.568/2019, "Për krijimin,mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" disponon dhe vë në dispozicion informacionin e dokumentuar në periudhën nga krijimi i saj e deri në ditët e sotme, pra duke filluar nga data 01.07.2020 e në vazhdim. Informacion të cilin sipas datave respektive dhe operatorëve përkatës e gjeni si më poshtë vijon:<br><br>Operatori "E***" shpk ka kryer 2(dy),dhe operatori "H****" shpk ka kryer 1(një), procedura/e, asgjësimi në të cilat ka qënë present inspektorët (specialistë) të sektorit të inspektimit pranë ARM-së TR/DR/DI.<br><br>1- Asgjësim të produkteve me përmbajtje shtazore,sipas kërkesës dërguar nga operatori më datë 17/11/2020 dhe Nr.1269.Prot,është realizuar asgjësimi i produkteve në datën 27/11/2020 ora 11.00, pesha totale e asgjësuar është 516,75 Kg, evadimi/riciklimi/asgjësimi i kryer nga operatori licencuar me III.2.B. "AZ-Rendering" shpk,dhe dokumentuar nga Formulari Transferimit të Mbetjeve<br>me Nr. ARG01552031,datë 27/11/2020 (Mbetje nga Indet Shtazore me Kod të Katallogut të Mbetjeve 02-02-02) 1-b-Asgjësim të produkteve ushqimore me prejardhje bylmeti (djathra,salca etj) me një peshë totale prej 780 Kg,evadimi/asgjesimi i kryer nga operatori i licencuar me III.2.B. "Green-Recycling"shpk,dokumentuar dhe nga Flet-Pranimi i Lanfillit të Sharrës me Nr.Serie 0199132 datë 27/11/2020.<br>2-Asgjesim i produkteve me permbajtje shtazore "Fileto Pule" sipas kerkeses bere nga operatori "EHË" me date 19/04/2021,Nr.965.Prot, dhe realizuar me date 21/04/2021,ora 09.00. Ne total sasia asgjesuar ishte 27.000 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **********<br>19.10.2021 | ****************<br>Fotokopjet e procesverbaleve në lidhje me sasinë e asgjësuar. - Mbetjet | *********<br>27.10.2021 | Kg (27 Ton). Asgjesimi u realizua nepermjet metodologjise se riciklimit nga kompania e Licencuar "Balcan Zoo Farma",vertetuar dhe nga dokumentat e transferimit te mbetjeve me kod unik BZF-0002,qe ky operator ka gjenerua Sasia e asgjesuar ishte e kontaminuar me Salmonele dhe bllokuar nga inspektoret e DRAKU Tirane,vertetuar dhe nga Proces Verbali i bllokimit te DRAKU me Nr.(AKU-TR-2021-001996-5).<br>3- Asgjesim te produkteve me permbajtje shtazore ,sipas kerkeses derguar nga operatori "HAKO" shpk me date 06/04/2021 Nr.913.Prot, dhe realizuar me date 07/04/2021 ora 10.30. Ne total sasia e asgjesuar/ricikluar ishte 3265 Kg,nga te cilat 2460 Kg Kocka nga lenda e pare dhe 805 Kg mbetje shtazore,keto mbetje u evaduan dhe trajtuan si mbetje nga operatori licencuar me III.2.B. "Balcan-Zoo-Farma" vërtetuar dhe nga dokumenti i transferimit të mbetjeve me kod unik BZF-000289, që ky operator ka lëshuar më datë 07.04.2021.<br><br>**************************************************<br>Info shtese percjelle nga MTM dt **19.10.2021**<br><br>**(percjelle per trajtim ARM Tirane Durres Diber) kthyer pergjigje me 26.10.2021.**<br>**AKM -> pergjigje MTM dt 27.10.2021**<br><br>Bazuar në kërkesën për informacion ardhur nga OraNeës Tv,kërkesë me Nr.105.Prot,datë 21.09.2021,kërkesë e cila është bazuar në nenin 22,pika 1 e Kushtetutës së R.SH. si dhe në Ligjin 119 të vitit 2014,"Për të Drejtën e Informimit" Mbi sasitë e produkteve të skaduara/dëmtuara | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shtazore janë produkte për asgjësim psh: sallam që është hequr nga tregëti-mi ose i referoheni diçkaje tjetër? | | të asgjësuara nga operatoret E*** dhe H***,Ju bëjmeë me dije se Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë/Durrës/Dibër bazuar në VKM-në Nr.568,datë 17.07.2019, "Për krijimin,mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare ëe Mjedisit" disponon dhe vë në dispozicion informacionin e dokumentuar në periudhën nga krijimi i saj e deri në ditët e sotme,pra duke filluar nga data 01.07.2020 e në vazhdim. Informacion të cilin sipas datave respektive dhe operatorëve përkatës e gjeni si më poshtë vijon:<br><br>Operatori "E***" shpk ka kryer 2(dy),dhe operatori "H***" shpk ka kryer 1(një), procedura/e, asgjësimi në të cilat ka qënë present inspektorët(specialistë) të sektorit të inspektimit pranë ARM-së TR/DR/DI.<br>1- a- Asgjësim të produkteve me përmbajtje shtazore,sipas kërkesës dërguar nga operatori më datë 17.11.2020 dhe Nr.1269.Prot, është realizuar asgjësimi i produkteve në datën 27.11.2020 ora 11.00,<br>pesha totale e asgjësuar është 516,75 Kg/evadimi/riciklimi/asgjësimi i kryer nga operatori licencuar me III.2.B. "AZ-Rendering" shpk,dhe dokumentuar nga Formulari Transferimit të Mbetjeve me Nr. ARG01****,datë 27.11.2020 (Mbetje nga Indet Shtazore me Kod të Katallogut të Mbetjeve 02-02-02)<br>1-b- Asgjësim të produkteve ushqimore me prejardhje bylmeti (djathra,salca etj) me një peshë totale prej 780 Kg,evadimi/asgjësimi i kryer nga operatori i licencuar me III.2.B. "Green-Recycling"shpk,dokumentuar dhe nga Flet Pranimi i Lanfillit të Sharrës me Nr.Serie 0199132 datë 27.11.2020. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2-Asgjësim i produkteve me përmbajtje shtazore "Fileto Pule" sipas kërkesës bërë nga operatori "EHË" me datë 19.04.2021,Nr.965.Prot, dhe realizuar më datë 21.04.2021,ora 09.00. Në total sasia asgjësuar ishte 27.000 Kg (27 Ton). Asgjësimi u realizua nëpërmjet metodologjisë së riciklimit nga kompania e Licencuar "B*** Zoo Farma",vërtetuar dhe nga dokumentat e transferimit të mbetjeve me kod unik BZF-0002,që ky operator ka gjeneruar Sasia e asgjësuar ishte e kontaminuar me Salmonelë dhe bllokuar nga inspektorët e DRAKU Tiranë,vërtetuar dhe nga Proces Verbali i bllokimit të DRAKU me Nr.(AKU-TR-2021-001996-5).<br>3.a.- Asgjësim të produkteve me përmbajtje shtazore ,sipas kërkesës dërguar nga operatori "H****" shpk më datë 06.04.2021 Nr.913.Prot, dhe realizuar më datë 07.04.2021 ora 10.30. Në total sasia e asgjësuar/ricikluar ishte 3265 Kg,nga të cilat 2460 Kg Kocka nga lënda e parë,805 Kg mbetje shtazore dhe 2370 kg sallamra dhe proshuta,këto mbetje u evaduan dhe trajtuan si mbetje nga operatori licencuar me III.2.B. "B***Zoo-Farma" vërtetuar dhe nga dokumenti i transferimit të mbetjeve me kod unik BZF-000289, që ky operator ka lëshuar më datë 07.04.2021.<br>3.b.Asgjësim i 2.370 kg(2.37 ton) produkte sallamra dhe proshuta të kryera nga kompania E***Empire dhe e dokumentuar me formular transferim EPR1462237, datë 07.04.2021 ora 11.20, si dhe flet pesha gjeneruar nga kjo kompani.<br><br>Vënë në dispozicion edhe procesverbalet e asgjësimit : H*** 2021 . E** 2021 , E** 2020 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 9 | 11.10.2021 | Informacion për aplikim mjedisor për hidrocentralin Hydro S*** në Dibër. | 11.10.2021 | U ngarkua Raporti i VNM dhe Vendimin për Hydro S***. | Përfunduar | Nuk ka |
| 10 | 11.10.2021 | Informacion për aplikim mjedisor për hidrocentralin T**** C***, Tropojë ? | 11.10.2021<br><br><br><br>*********<br>12.10.2021 | Pas verifikimit në databazën tonë,<br>nga periudha Janar, 2014 e deri më tani, nuk ka aplikim për procedurat e VNM nga subjekti "T**** C****" sh.p.k.<br><br><br>*****************************************************<br>**nga VNM** -> Lidhur me informacionin e kërkuar për T*** C****, Ju bëjmë me dije se ky subjekt është pajisur me Leje Mjedisore në vitin 2013, për disa HEC-e në Valbonë. Procedura është kryer në bazë të Ligjit Nr. 8934, datë: 05.09.2002, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i shfuqizuar, në një periudhë ku aplikimet kryheshin në QKB (ISH QKL) dhe Vendimi lëshohej nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe jo nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.<br><br>Për çdo informacion, për periudhën përpara Janar, 2014, lutemi drejtohuni Qëndrës Kombëtare të Biznesit si dhe vizitoni linkun:<br>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/kerko-per-statusin-e- | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | aplikimit-per-licence-leje. | | |
| 11 | 11.10.2021 | Informacion për aplikim mjedisor për hidrocentralin H****** në lumin Gashi Tropojë ? | 11.10.2021<br><br><br><br>*********<br>12.10.2021 | Pas verifikimeve në databazën tonë, që nga periudha Janar, 2014 e deri tani nuk ka aplikim në AKM nga subjekti "H******" për procedurat e VNM për HEC Gashi.<br><br>..............................................................<br><br>**nga VNM**,-> Lidhur me informacionin e kërkuar për H****, Ju bëjmë me dije se ky subjekt është pajisur me Leje Mjedisore në vitin 2013. Procedura është kryer në bazë të Ligjit Nr. 8934, datë: 05.09.2002, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i shfuqizuar, në një periudhë ku aplikimet kryheshin në QKB (ISH QKL) dhe Vendimi lëshohej nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe jo nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.<br><br>Për çdo informacion, për periudhën përpara Janar, 2014, lutemi drejtohuni Qëndrës Kombëtare të Biznesit si dhe vizitoni linkun: https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/kerko-per-statusin-e-aplikimit-per-licence-leje. | Përfunduar | Nuk ka |
| 12 | 20.10.2021 | Informacion i kërkuar nëse ka patur inspektime | 08.11.2021 | Bëjmë me dije se Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nuk ka kryer asnjë inspektim lidhur me mbetjet e ngurta në territorin e Bashkisë Durrës. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për mbetjet e ngurta në Qarkun e Durrësit, në vijim të situatës së rënduar të mbetjeve urbane gjatë sezonit veror? Venia në dispozicion e Raportit Përmbledhës i statistikave vjetore të mbetjeve për vitin 2020 ? | | Së pari ju informojmë se termi 'mbetje të ngurta' i referohet dy rrymave të mbetjeve, atyre inerte dhe mbetje të ngurta urbane.<br>Mbetjet inerte, në zbatim të Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 **'Për Menaxhimin e Integruar Të Mbetjeve',** i ndryshuar, menaxhohen duke u depozituar vetëm në Landfill-e të miratuara për këtë qëllim, referuar *kjo Kreut VII 'Lendfillet e Mbetjeve' Neni 43 'Kategoritë e lendfilleve', pika 5. Lendfillet për mbetjet inerte përdoren vetëm për mbetjet inerte.* Pas mbylljes së venddepozitimit të Porto-Romanos për arsye të tejkalimit të kapacitetit të këtij vendgrumbullimi, me vendim të Qeverisë Shqipëtare, të gjitha mbetjet inerte të gjeneruara nga procesi i rindërtimit pas tërmetit të 26 Nentorit të vitit 2019, u vendosën të grumubullohen dhe depozitohen në ish vendgrumbullimin e mbetjeve urbane të Porto-Romanos për të realizuar inkapsulimin e kësaj pike.<br>Së dyti, referuar Ligjit Nr. 139/2015 'PËR VETËQEVERISJEN VENDORE', menaxhimi i plotë i mbetjeve urbane është kompetence e drejtpërdrejtë ligjore e bashkive, të cilat e kontrollojnë këtë proces përmes tenderimit të shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe asgjësimit përfundimtar të mbetjeve me natyrë urbane, përmes kontratave të shërbimit.<br>Informacionet statistikore për sa më lart duhet të kërkohen në strukturat përgjegjëse kompetente.<br>Për të dhëna sa më të sakta dhe të qarta lidhur me këtë çështje ju lutemi ti drejtoheni Bashkisë Durrës dhe Inspektoriatit Shtetëror të Mbrojtjes së Territorit, Dega Rajonale Durrës. | | |
| 13 | 22.10.2021 | Informacion nëse Karburantet e Gazit a duhet të pajisen | 25.10.2021 | Në vlerësim të kërkesës tuaj për ju bëjmë me dije se: | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me Leje Mjedisi të Tipit B apo C ?! | | Instalimet për "Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane" dhe "Gaz natyror aromatik ose GNL përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me Tipin A, ose përzierje e aromave" janë të përfshira në Shtojca 1 të Ligjit Nr. 52/2020 datë 30.04.2020 "Për Lejet e Mjedisit" dhe duhet të pajisen me Leje Tipi B. | | |
| | ********** 25.10.2021 | *************** Për sa i përket pikve të gazit në këtë Nipt duhet të pajisem me Lejë të Tipit B, dhe ku mund të aplikoj për këtë lejë ? | ********* 25.10.2021 | ************************************************* Të gjitha veprimet që do të ndjekë operatori duhet të kalojnë nëpërmjet QKB-së, sistemi on-line referuar Ligjit Nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe VKM Nr. 538, date 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar. | | |
| 14 | 26.10.2021 | Informacion për dëmet mjedisore që shkaktojnë operatorët privat e publik, kryesisht ato në fushën | 02.11.2021 | Për sa i përket informacionit të kërkuar nga ana juaj në lidhje me dëmet mjedisore në Rajonin e Kukësit, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon :<br><br>Për sa i përket procedurës së VNM-së, konkretisht pjesa e konsultimit me publikun, lutemi rastet konkrete se ku | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | minerare, HEC-et por edhe operatorë të tjerë në territorin e bashkisë të Kukesit?<br>Do të kërkoja nga institucioni juaj, numrin e kontrolleve që keni kryer në territorin e kësaj bashkie dhe si kane rezultuar këto kontrolle. A keni konstatuar shkelje dhe çfarë masash janë marrë?. Sa është numri i tyre?. A janë të pajisura firmat me leje mjedosore?, A i kanë rinovuar ato?. Banorë të fshatrave ku operojnë këto firma hedhin akzua se lejet mjedosire janë marrë në sajë të firmave të falsifikuara dhe nuk është marrë kontakt me banorët vendas.<br>Cili është mendimi juaj lidhur me këto | | mendohet që është bërë fallsifikimi.<br><br>Në qarkun Kukës operojnë shumë subjekte dhe identifikimi i rastit do të lehtësonte dërgimin e informacionit.<br>Ju bëjmë me dije se kërkesa dhe procedura e konsultimit me publikun kryhet konform të gjitha rregullave që përcaktojnë VKM-të përkatëse.<br>Në rast se ka fallcifikime të firmave të banorëve, personat që i kanë bërë mbajnë përgjegjësi ligjore.<br><br>Në vlerësim të kërkesës tuaj se "A janë të pajisur firmat me leje mjedisore" ju informojmë se të gjitha subjektet që janë mbajtës të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve janë të publikuara në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Ju mund të kontrolloni për çdo informacion, aktivitet apo subjekt aktiv në linkun e mëposhtëm. https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/<br>Regjistri Kombëtar i Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, ka për qëllim të sigurojë aksesin e lirë të publikut në përputhje me ligjin.<br><br>Përsa i përket inspektimeve ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:<br>Gjatë periudhës nga fillimi i qershorit të këtij viti dhe deri në mbylljen e muajit që lamë pas në fushën për të cilën janë kërkuar informacione nuk janë kryer inspektime pasi përgjithësisht fusha jonë e inspektimit është shtrirë në zbatueshmërinë e kushteve të lejës mjedisore, të subjekteve që janë pajisur me leje mjedisore, nga ku siç e dimë Hec-et nuk janë pjesë përbërëse e shtojcës Nr.1 të ligjit "Për Lejet e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | akuza? | | Mjedisit".<br>Megjithatë gjatë periudhës në fjalë janë kryer afërsisht 21 inspektime për qarkun e Kukësit, përgjithësisht referuar industrisë minerare, nga të cilat në pjesën më të madhe të tyre nuk janë evidentuar problematika të tilla si mospaisja me lejën përkatëse, pasi siç u theksua dhe më sipër inspektimet janë ushtruar në subjekte të pajisura me lejet përkatëse mjedisore. Nëse janë konstatuar problematika ato kanë qënë problematika të vogla përgjithësisht në dokumentacion. Megjithatë për më shumë informacion I'u sugjerojmë ti drejtoheni zyrës së ARM-së Shkodër-Lezhë-Kukës, sektorit të përpunimit të informacionit në qarkun përkatës pasi atyre ju referohet çdo informacion i dalë nga sektori jonë në lidhje me realizimin e planeve tona mujore. | | |
| 15 | 28.10.2021 | Sa është kapaciteti i Landfillit të Sharrës për mbetjet inerte ? | 01.11.2021 | I**** E**** BV SPV" sh.p.k. është pajisur me Vendim për VNM Paraprake në Komisionin K.Nr. 18/ 2019 për projektin: "Landfill i mbetjeve inerte **(_Pika 4_)**" me vendodhje fshatin Sharrë, Vaqarr, Tiranë. Volumi maksimal i parashikuar në projekt është 400000 $m^3$<br><br>"I**** E**** BV SPV " sh.p.k. është pajisur me Vendim për VNM Paraprake në Komisionin K. Nr. 21/2019 për projektin: "Landfill i mbetjeve inerte **(_Pika 12_)**" me vendodhje fshatin Sharrë, Vaqarr, Tiranë. Volumi maksimal i parashikuar në projekt është 518000 $m^3$ | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 16 | 28.10.2021 | 1. Sa është kapaciteti i Landfillit të Sharrës për mbetjet inerte?<br>2. Sa përqind e këtij kapaciteti është ezauruar?<br>3. Çfarë ndodh me mbetjet inerte (dërgohen diku, shiten)?<br>4. Nga cilat bashki pranojnë aktualisht mbetjet inerte? | 01.11.2021 | "I**** E**** BV SPV" sh.p.k. është pajisur me Vendim për VNM Paraprake në Komisionin K.Nr. 18/ 2019 për projektin: "Landfill i mbetjeve inerte **(_Pika 4_)**" me vendodhje fshatin Sharrë, Vaqarr, Tiranë. Volumi maksimal i parashikuar ne projekt është 400000 $m^3$<br><br>"I***** E**** BV SPV" sh.p.k. është pajisur me Vendim për VNM Paraprake në Komisionin K. Nr. 21/2019 për projektin: "Landfill i mbetjeve inerte **(_Pika 12_)**" me vendodhje fshatin Sharrë, Vaqarr, Tiranë. Volumi maksimal i parashikuar ne projekt eshte 518000 $m^3$ | Përfunduar | Nuk ka |
| 17 | 29.10.2021 | Informacion a ka një ragim nga AKM | 10.11.2021 | Në mbështeje të **Ligjit Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, Ligjit Nr.52/2020 'Për** | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për bizneset që nuk respektojnë kushtet e lejës së mjedisit për sa i përket hedhjes së mbeturinave në lumin ISHËM që përfundojnë në detin Adriatik ? A ka vendosur gjoba AKM për binzenset që nuk kanë menaxhuar mbetjet dhe i kanë depozituar në lumin Ishëm ? | | **lejet e mjedisit' i ndryshuar, VKM Nr. 568, datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"**, ju informojmë se:<br><br>Që nga data e krijimit dhe funksionimit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tiranë, Durrës, Dibër, nuk është kryer asnjë inspektim dhe nuk është marrë asnjë masë administrative për subjektet të cilat operojnë pranë lumit Ishëm.<br>Referuar Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 'PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE', i ndryshuar, Neni 21, Pika 12 *'Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji'* .<br><br>Lutemi ti drejtoheni Njësisë së Qeverisjes Vendore dhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Struktura përgjegjëse përkatëse. | | |
| | *********<br>09.11.2021 | ****************<br>Po bej nje shkrim per investimin e kryer nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit perpara 4 viteve ne Impiantin e pastrimit te grykederdhjes se lumit Ishmit dhe tani pothuajse ka dale jashte | *********<br>11.11.2021 | ************************************************<br>Agjencia Kombëtare e Mjedisit në mbështetje të VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 për "Rregullat dhe proçedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" pika B 4.1. a-f , B 4.2.a-b, Ç4-b realizon programin e monitorimit me temë: *"**Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë në lumenj, liqene dhe zona bregdetare si dhe ndikimi i shkarkimeve të lëngëta urbane në cilësinë e tyre",*** ku pjesë e këtij programi është edhe Baseni Ishëm - Erzen.<br>**Lumi Ishëm** rrjedh përmes Shqipërisë Qendrore me një | | |

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td>funksionit, ku nje prej barrierave eshte prishur. Raportet e monitorimit te organizates nderkombetare te “ The Ocean Clean Up”, e nxjerrin lumin e Ishmit si lumi i trete me i ndotur ne Europe. A keni nje koment per kete ceshtje</td>
<td></td>
<td>gjatësi rreth 74 km i cili  formohet nga bashkimi i Lumit të Tiranës, delta e të cilit ndodhet në Kepin e Rodonit.<br>Lumi Ishëm monitorohet me frekuencë 4 herë/vit në tre stacione me koordinata gjeografike si në tabelën më poshtë.
<table>
<tr><th>Nr.</th><th>Kodi i kampionit</th><th>Emërtimi i Lumit</th></tr>
<tr><td>1.</td><td>Ish1</td><td>Lumi Ishëm</td></tr>
<tr><td>2.</td><td>Ish2</td><td>Lumi Ishëm</td></tr>
<tr><td>3.</td><td>Ish3</td><td>Lumi Ishëm</td></tr>
</table>
<table>
<tr><th>Vëndndodhja</th><th>Koordinatat gjeografike</th></tr>
<tr><td>Ura Rinas</td><td>N 41.435932<br>E 19.696267</td></tr>
<tr><td>Ura e Gjolës</td><td>N 41.467270<br>E 19.691924</td></tr>
<tr><td>Ura Salmer</td><td>N 41.541421<br>E 19.610609</td></tr>
</table>
Parametrat e monitoruar janë: temperatura e ujit, pH, alkalinitet, saliniteti, përcjellshmëria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, $NBO_5$, nitritet, nitratet, amonjaku, $P_{total}$, $PO_4$,dhe lënda pezull.<br>Klasifikimi i cilësisë kryhet bazuar në  vlerat limite sipas Direktivës Kuadër të Ujit.<br>Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat vlerësojmë se cilesia e statusit kimik për stacionet e monitoruar paraqitet në tabëlën e mëposhtme:
<table>
<tr><th>Stacioni/Klasifikimi</th><th>Klasa sipas DKU</th></tr>
</table>
</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ura Rinas — Klasa V – Gjendje e keqe<br>Ura e Gjoles — Klasa V – Gjendje e keqe<br>Ura Salmer — Klasa V – Gjendje e keqe<br><br>Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat, vleresojmë se në stacionet e referencës lumenjtë janë të pastër, ndërsa duke kaluar afër zonave të banuara impakti i shkarkimeve urbane të paligjshme të cilat derdhen direkt të patrajtuara sjell këtë klasifikim me një ndotje të lartë.<br>Lidhur me investimin për Impiantin e pastrimit të grykëderdhjes së Lumit Ishëm realizuar nga MTM ne nuk e disponojmë informacionin e kërkuar nga ju, informacion të cilin e gjeni pranë Ministrisë. | | |
| 18 | 08.11.2021 | 1- Një kopje të raportit të thelluar të VNM-së, të dorëzuar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës" zhvillues të së cilës janë bashkimi i përkohshëm i shoqërive “M***”, | 10.11.2021 | Në përgjigje të kërkesave tuaja Ju bëjmë me dije si më poshtë:<br>Aktiviteti “Ndërtim Aeroporti” është një projekt që i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së dhe pajiset me Deklaratë Mjedisore, në bazë të Ligjit Nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Shtojca I, Pika 7. b) Ndërtimi i aeroporteve me pista që kanë një gjatësi bazë prej 2 100 m ose më tepër. Në kuptim të këtij ligji “aeroport” nënkupton aeroporte, të cilat përputhen me përkufizimin e dhënë në Konventën e Çikagos më 1944, që themeloi Organizatën Ndërkombëtare Civile të Aviacionit (Shtojca 14 e kësaj konvente).<br>Procedura që ndiqet për pajisjen me Deklaratë nga Ministri përgjegjës për mjedisin, kryhet nëpërmjet sistemit on-line “e-albania”, në bazë të VKM Nr. 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | “Y***** ” dhe “**** Group” Sh.p.k.<br><br>2- Një kopje të dokumentit mbi mendimin e parashtruar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për dokumentacionin e paraqitur nga zhvilluesi për vlerësimin në ndikimin në mjedis për “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës" zhvillues të së cilës janë bashkimi i përkohshëm i shoqërive “M*****”, “Y***” dhe “*** Group” Sh.p.k.<br><br>3- Një kopje të Deklaratës Mjedisore për | | zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar.<br><br>Sipas VKM Nr. 686/2015 (e ndryshuar), Kreu II, “ZHVILLIMI I PROCEDURËS SË THELLUAR TË VNM-së”, Pika 1.Zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, icili është subjekt i procedurës së thelluar të VNM-së, njofton, me shkrim, ministrinë që në fazat fillestare të zhvillimit të projektit (projekt-idesë), duke e shoqëruar me informacionin përkatës.<br><br>Shoqëria “Vlora International Airport - VIA”, e ka kryer këtë procedurë nëpërmjet sistemit e-albania dhe është pajisur me Njoftim për vazhdim proçedure për VNM të Thelluar, me nr. AN130920210004, datë: 29.10.2021, për projektin “Ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferim e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)" me vendodhje në afërsi me zonën e Novoselës, Akërni, Vlorë.<br><br>Pas marrjes së njoftimit, është bërë edhe kërkesa për dëgjesën me publikun, sipas VKM Nr.686/2015 dhe VKM-së Nr. 247, datë 30.4.2014. “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të proçedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.<br><br>Bazuar në VKM Nr.247/2014, kërkesa është publikuar në faqen zyrtare të AKM-së, sipas linkut<br><br>http://ëëë.akm.gov.al/assets/p%c3%abrmbledhje---joteknike.pdf<br><br>Ende nuk është zhvilluar dëgjesa me publikun, pasi nuk është plotësuar afati për t’u kryer sipas VKM Nr.247/2014.<br><br>Pas kryerjes së dëgjesës publike, zhvilluesi vazhdon me hartimin e Raportit të Thelluar të VNM-së, ku në të pasqyrohen të gjitha konsultimet e kryera përpara fazë së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës" zhvillues të së cilës janë bashkimi i përkohshëm i shoqërive “M****”, “Y****” dhe “*** Group” Sh.p.k.<br><br>4- Një kopje të kalendarit të dëgjesave publike që Agjencia Kombëtare e Mjedisit do te zhvilloj per VNM-së së thelluar, me publikun dhe grupet e interesuara për “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës" zhvillues të së cilës janë bashkimi i | | VNM-së Thelluar.<br><br>Për sa më sipër, në fazën që ndodhet projekti (faza paraprake e konsultimeve) po Ju dërgojmë:<br><br>• Raportin Teknik<br>• Informacion lidhur me ndërveprimin në mjedis të projektit të propozuar<br>• Shkresën Njoftim për vazhdim proçedure për VNM të Thelluar, me Nr. AN130920210004 / 2021, ku pasqyrohen edhe mendimet e instiucioneve të konsultuara.<br><br>U vunë në dispozicion edhe Raporti Teknik, Njoftimi për zhvillimin e VNM-së të Thelluar, Informacion pë r Ndërveprimin në Mjedis. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përkohshëm i shoqërive “M****”, “Y****” dhe “** Group” Sh.p.k.<br><br>5- Një kopje të dokumentit mbi mendimet dhe komentet e parashtuara ne Agjencine Kombëtare e Mjedisit për “Projektim, ndërtim, operim, mirëmbajtje dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës" zhvillues të së cilës janë bashkimi i përkohshëm i shoqërive “M****”, “*****” dhe “*** Group” Sh.p.k. | | | | |
| 19 | 09.11.2021 | Sa është numri i subjekteve gurore/ karriera sipërfaqësore, | 12.11.2021 pergjigje Esmeralda Ketes dhe | Në zbatim të ligjit Nr.119/2014 “*Për të drejtën e informimit*” Ligji Nr.10433/2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, ligji Nr.52/2020 “*Për lejet e mjedisit*”, ligji Nr.10463/2011 “*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*” i | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | prodhim çimento apo gëleqere që kanë ushtruar aktivitetin që nga viti 2010 e deri më tani? Ju lutem i specifikoni sipas llojit të aktivitetit ?<br>Sa prej tyre kanë bërë rehabilitimin e mjedisit? Kur është periudha kohore që kanë bërë rehabilitimin? Sa është sipërfaqja e rehabilituar dhe sa është shuma e shpenzuar për rehabilitimin?<br>Sa është numri i gjobave të vendosura ndër vite nga AKM për mosrespektim nga ana e këtyre subjekteve?<br>Sipas pushteti lokal, çdo subjekt kryen vetëmonitorim nga studio të licencuara dhe raportin me rezultate e dorëzon | me dt 15.11.2021 Komisioner it per te Dr. e Info | ndryshuar, VKM Nr.568/2019 “*Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*”,<br>**Pika1** Nga verifikimi në regjistrin kombëtar të lejeve dhe licencave dhe autorizimeve pranë QKB- rezultojnë 280 subjekte të pajisura me leje mjedisi për gurore/karriera sipërfaqësore. (Ky informacion përmbledh të dhëna që nga krijimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.<br><br>**Pika 2** Subjektet e guroreve garancinë financiare për rehabilitimin e mjedisit e kryejnë pagesën pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore çdo vit. Për informacion më të detajuar për pjesën e rehabilitimit të mjedisit lutemi ti drejtoheni institucionit në fjalë.<br><br>**Pika 3** Për guroret që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Beratit janë ushtruar inspektime nga ana jonë dhe janë marrë masa si më poshtë:<br>Në zonën e Dëvrisë ( Bashkia Skrapar) janë vendosur 7 – masa administrative “ Pezullim”<br>Në zonën e Novajt ( Bashkia Skrapar) janë vendosur 10 – masa administrative “ Pezullim”<br>Në zonën e Gurit të Bardhë ( ish Bashkia Ura Vajgurore) janë vendosur 12 – masa administrative “ Pezullim”.<br><br>Informacion për guroret që ndodhen në zonën e mbrojtur ‘ Krastë-Verjon’.<br>Për guroret qe ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Durrësit, Krujë janë ushtruar inspektime nga ana jonë dhe janë marrë masa si më poshtë:<br>Në zonën e mbrojtur ‘ Krastë-Verjon’ janë vendosur 12 gjoba si dënim kryesor dhe për të 12 këto subjekte është vendosur Pezullim i plotë i aktivitetit si dënim plotësues. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pranë AKM. A dispononon AKM raporte të tilla? Nëse po nga cilat dhe subjekte dhe a mund të na i vini në dispozicion | | **Pika 4** Përsa i përket kësaj kërkese ju informojmë se pranë AKM të gjithë subjektet që operojnë në veprimtarinë gurore në bazë të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar kryejnë dhe dorëzojnë pranë AKM raportet e vetmonitorimit çdo 6 muaj të ushtrimit të aktivitetit. Referuar kërkesës tuaj për vënien në dispozicion të këtyre raporteve lutemi të na specifikoni zonat apo emrat e subjekteve si dhe periudhën për të cilën kërkoni informacion pasi është e pamundur dërgimi i materialit nga ana jonë për shkak të volumit të madh të dokumentacionit të raporteve të vetmonitorimit të dorëzuar në AKM nga subjektet në periudha të ndryshme. | | |
| 20 | 11.11.2021 | Kërkohet informacion nga ARM Lezhë, në lidhje me dëmet mjedisore që shkaktohen nga operatorët në fushën minerere/ HECET në Bashkinë e Kukësit !!! | 15.11.2021 | ARM,ushtron kontrolle të planifikuara dhe të miratuara në subjekte që janë të pajisura me Leje Mjedisore, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Inspektime jashtë planit të miratuara, bëhen në kushtet e konstatimit në flagrancë, të ndonjë dëmi mjedisor, kur njoftohemi nga palë të treta për këto situata (banor,subjekte,apo institucione). Rastet e flagrancës ndiqen nga disa institucione.<br><br>Nisur nga kërkesa për inspektimet dhe vlefshmërin e Lejeve Mjedisore të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin minerar në Qarkun Kukës ju informojmë si më poshtë:<br>: 1. Në bazë të evidencave të inspektimeve të ardhura nga Sektori i Inspektimeve ARM Shkodër, Lezhë, Kukës rezulton se janë realizuar inspektime në subjektet që veprojnë në fushën minerare gjithësej 19 inspektime .<br>2 . Nga këto kemi 12 subjekte që zbatojnë kushtet e lejës mjedisore dhe rrjedhimisht quhen të rregullt .<br>3 . Tre subjekte kanë mbyllur aktivitetin për një periudhë të pacaktuar . | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 4. Katër subjekte janë penalizuar me masë administrative ( gjobë ) për shkelje të kushteve të lejës mjedisore , ku njëra nga këto për mungesë të Lejës Mjedisore . Vlera e gjobave rezulton 1 rast 20 mijë lekë . 1 rast 300 mijë lekë , dhe 2 raste me 500 mijë lekë .<br>5. S'ka referime në Prokurori | | |
| 21 | 15.11.2021 | Informacion për tu vënë në dijeni nëse shërbimi i isnpektoriatit të pyjores në Korçë vazhdon të funksionojë apo jo ? Kush është drejtori i këtij institucioni ?<br>Përse i ka marrë në kompetencë Bashkia Korçë mbrojtjen e pyjeve? | 15.11.2021 | Agjencia Kombëtare e Mjedisit në zbatim të VKM –së Nr.568/2019 është institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.<br>Fusha e veprimtarisë është vetëm ekzekutive dhe ligjzbatuese sipas hierarkisë institucionale dhe akteve ligjore në fuqi. | Përfunduar | Nuk ka |
| 22 | 15.11.2021 | Kërkohet informacion nga banorët e Krrabës nëpërmjet Avokatit të Popullit kundjet kompanisë "G*****" për moslejimin e ushtrimit të aktivitetit për prodhimin e asfalto | | I është përcjellë për trajtim Agjencisë Rajonalë të Mjedisit Tiranë/Durrës/ Dibër. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | betonit duke shkaktuar ndotje në ekosistem.<br><br>Komisioneri i Av. të Popullit ka kërkuar informacion :<br><br>1- A janë kryer kontrolle lidhur me zbatimin e lejës mjedisore Nr.3160 /2020<br>2- Dokumentacionin provues<br>3- Nëse është ushtruar kontroll cili ka qënë konstatimi dhe nëse jo, pse nuk janë ushtruar këto kontrolle ? | | | | |
| 23 | 15.11.2021 | Kërkesë për tu pajisur me Certefikatën e impaktit në mjedis për shoqërinë A***** sh.p.k | 22.11.2021 | I është dërguar certafikata e plotësimit të standarteve mjedisore në kuadër të projektit të IPARD-II | Përfunduar | Nuk ka |
| 24 | 18.11.2021 | Kërkesë për informacion mbi | 22.11.2021 | Lidhur me kërkesën për informacion dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit mbi Inspektimet, dëmtimet, | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | inspektimet, ndotjet dhe masat administrative të lumit Erzen ! | | konstatimet, masat e marra për mbrojtjen e lumit Erzen, si dhe cilat kompani janë të liçensuara për shfrytëzimin e inerteve të lumit Erzen, ju bëjmë me dije si vijon:<br><br>Drejtoria e Inspektim-Kontrollit(DIK), në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit(AKM), gjatë Monitorimit, Verifikimit dhe kontrollit që ka bërë përgjatë shtratit të lumit Erzen,në mbështetje të legjislacionit në fuqi, ka konstatuar ndërhyrje në shtratin e lumit dhe hedhje,<br>depozitim materialesh inerte në brigje, veprime të cilat përbëjnë kundravajtje administrative dhe për pasojë ka marrë këto masa ndaj subjekteve,duke vendosur këto dënime:<br><br>- Subjekti “A..... I......”shpk, ka kryer ndërhyrje dhe gërmime në shtratin e lumit Erzen dhe si pasojë, ndaj tijë është marrë masë Administrative, dënim me gjobë në masën 1000000 lekë.<br><br>- Subjekti “ B.... E......” shpk, ka kryer hedhje, depozitim të materialeve Inerte, të dala nga prishja e subjekteve ndërtimore në bregun e lumit Erzen dhe si pasojë, ndaj tij është marrë masë Administrative, dënim me gjobë në masën 1000000 lekë.<br><br>Në dijeninë tonë dhe mbështetur në legjislacionin në fuqi, nuk ka kompani që janë të liçensuara për shfrytëzimin e inerteve në lumin Erzen. | | |
| 25 | 19.11.2021 | Kërkohet | 22.11.2021 | | Përfunduar | Nuk |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | informacion nëse ka një vend grumbullim inertesh në fshatin Stërmas ? | | Në vlerësim të kërkesës dhe shpjegimeve subjektet pajisen me leje mjedisi në bazë të subjektit aplikues (NUIS), Veprimtaria, Vendndodhje.<br>Për të vënë në dispozicion informacionin përkatës duhen elementët për të berë të mundur identifikimin e subjektit dhe përshkallëzimin e kërkimit nëse subjekti është mbajtës i ndonjë leje/licencë, apo autorizim. Po ju vemë në dispozicion edhe linkun e Regjistrit Kombëtar të Licencave, Lejeve dhe Autorizimeve.<br><br>https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/ | | ka |
| 26 | 22.11.2021 | Pse Himara rezulton zona më e ndotur në vend?<br>Sa ton mbetje prodhon Himara (qyteti dhe zona bregdetare) në një ditë? Po në një vit?<br>Ku depozitohen mbetjet? Sa kushton?<br>Sa para ka marrë kjo Bashki nga shteti për pastrimin?<br>Shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, Bashkia e | 25.11.2021 | Nga Agjencia Kombëtare e Ujesjëllës Kanalizimeve dhe Menaxhimit të mbetjeve të Ngurta (AKUM) për vitin 2020 është raportuar se Bashkia Himarë prodhon 6.7 Kg/banorë në vit Mbetje Urbane. Sasia totale e gjeneruar të mbetjeve urbane është 4107.70 ton në vit. Sasia totale e mbetjeve inerte të prodhuara është 30000 ton ne vit, ndërsa mbetjet e depozituara në landfill janë 4107.70 ton për vitin 2020.<br><br>Bashkia Himarë i dërgon mbetjet në venddepozitimin e Bajkalit.<br><br>Përsa i takon pyetjeve të tjera, bashkitë nuk e kanë kopetencë ligjore të raportojnë në AKM. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Himarës e ofron në të gjithë territorin e saj apo një pjesë mbetet pa shërbim?<br><br>A ka bërë kjo Bashki kërkesë për para për pastrimin për vitin 2022 qëllim? | | | | |
| 27 | 23.11.2021 | Kërkesë për informacion për ndërtimin e 4 Hece-ve në lumin Shushica nga shoqeria "S******".<br>Kopje të aplikimit të "S****" për ndërtimin e 4 HEC-eve mbi lumin Shushicë, për leje mjedisore;<br>· Kopje të procesverbalit/ve për zhvillimin e dëgjesës/ve publike të zhvilluar gjatë vitit 2021 për këtë projekt;<br>· Kopje të akteve të njoftimit të këtyre | 25.11.2021 | U vendosën në dispozicion të kërkuesit :<br><br>- Përmbledhja joteknike<br>- Konsultimi publik<br>- Kërkesa për konsultim<br>- Formulari i aplikimit | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dëgjesave publike;<br>· Kopje të VNM-së mbi të cilin janë zhvilluar dëgjesa publike; | | | | |
| 28 | 24.11.2021 | A është miratuar Deklrata Mjedisore për ndërtimin e aeroportit të Vlorës ? Në qoftë se po, kërkoj një kopje të saj. Cilat janë hapat e ndërmarrë prej jush për konsultimin me publikun sipas ligjit në fuqi ? A janë zhvilluar dëgjesa me publikun për këtë projekt ? Nëse po, kërkoj të me vihen në dispozicion. A është marrë mendimi i AKZM, nëse po cili ka qënë qëndrimi i tij? | 25.11.2021 | U vendosën në dispozicion të kërkuesit informacioni i kërkuar dhe dokumentat shkresore. | Përfunduar | Nuk ka |